

# “ISHA BULLIZUES”

i Andrea Franzosos

## SKEDA 2

### KAPITULLI 4-5-6



“Asgje nuk është me e frikshme sesa te ndihesh ndryshe nga te tjeret”

Impakti i institutit profesional Çezare Korrenti qe shumë i fortë për Danielin: ndihej si i huaj, ndryshe prej të tjerëve. Çfarë kanë të përbashkët shokët?

1. pamjen e jashtme:

\_\_\_\_\_

2. transportin:

\_\_\_\_\_

3. aspektin fizik:

\_\_\_\_\_

Sipas teje, çfarë është e rëndësishme që të kenë personat të përbashkët për të formuar një grup? Mendo për një grup ku bën pjesë dhe përpiku të identifikoni se çfarë ju bashkon.

\_\_\_\_\_

A je ndjerë ndonjëherë i përjashtuar, sepse për ndonjë arsye nuk ishe si të gjithë të tjerët në një grup? A ke parë t'i ketë ndodhur ndonjërit kjo gjë? Çfarë ke bërë?

\_\_\_\_\_

### Fjalët janë të rëndësishme

1. “Është si të flasësh me murin”, i thotë e ëma Danielit. Reflekto për këtë krahasim: e përdorim aq shpesh sa nuk mendojmë më për kuptimin e tij. Sipas teje, për çfarë të bën të mendosh imazhi i murit?

\_\_\_\_\_

2. Danieli përgjigjej me fjalë **njërrrokëshe**, dhe ndonjëherë nuk e bënte as atë përpjekje: vetëm hungërinte apo kërciste gjuhën në shenjë mosmiratimi. Çfarë do të thotë “fjalë njërrrokëshe”?

- Tinguj pa kuptim.
- Fjalë të shqiptuara duke i ndarë në rrokje.
- Fjalë të formuara nga një rrokje e vetme.

Hungërimë do të thotë \_\_\_\_\_ dhe këtu tregon \_\_\_\_\_

3. Danieli e Rita nuk dinë t'i gjejnë fjalët, nuk arrijnë të komunikojnë. Sipas teje, pse ndonjëherë është e vështirë që të flasësh me prindërit e tu? A të ndodh edhe ty? A të vjen keq për këtë apo e konsideron normale në përgjithësi?

\_\_\_\_\_

### Përcaktimi i ndjenjave

**1. MËRZIA:** Kur dita është e zbrazët dhe nuk ka pasione që i tërheqin mendimet tona, nuk dimë çfarë të bëjmë dhe cilën rrugë të ndjekim. Ndonjëherë veprimet “e këqija” lindin nga mërzia: jep një shembull nga libri.

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**2. XHELOZIA:** çfarë është xhelozia? Përpiku ta përshkruash me fjalët e tua. Cili është ndryshimi mes zilisë dhe xhelozisë?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**3. AGRESIVITETI:** shfaqja e dhunës, qoftë verbale apo fizike, ndaj të tjerëve. Cili është qëndrimi më agresiv i Danielit, sipas mendimit tënd?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

### Reflektim personal:

#### FLAS PËR VETEN PËRMES KËNGËVE

Çdo nxënës përgatit një copë letër sa 1/4 e një flete A4 dhe shkruan një pjesë kënge që e përfaqëson atë. Mund të jetë muzikë rep, muzikë pop, muzika apo kënga e ndonjë filmi vizatimor, etj. fletët mblidhen dhe mësuesi i merr një nga një dhe i lexon me zë të lartë: nxënësit duhet të gjejnë se kush e ka shkruar atë pjesë kënge.

#### DEBAT: PËR ADOLESHENTËT MARKA

##### ËSHTË GJITHÇKA

“Blerja e rrobave firmato do të thoshte identifikim me diçka popullore, të famshme”, të suksesshme, të miratuar dhe të vlerësuar nga të tjerët. Gjë që më pas të bën të ndihesh më i sigurt. Por ne nuk jemi gjërat që veshim, pamja e jashtme tregon vetëm një pjesë të vogël të vetes sonë... Si mendoni ju? Çfarë fshihet pas zgjedhjes së një marke? Vetëm çështje shijeje apo edhe diçka tjetër? Flisni për këtë në klasë.

## NDJENJA: DASHURIMI

Gjatë adoleshencës, shpesh përjetojmë rrahjet e para të zemrës: një emocion i ri, i panjohur më parë, që na surprizon. Kur vjen ky moment, Danieli nuk është ende gati.

E para që dashurohet është Marika: kur i fliste, “dhe prej emocioneve në stratosferë nuk kujtonte saktësisht se çfarë i kishte thënë. Ishte e magjepsur”. Nga këto pak fjalë mund të nxjerrim “simptomat” e para të rënies në dashuri apo të dashurimit: cilat janë ato? A mund të listosh ndonjë tjetër?

Problemi i Danielit është që nuk arrin të dalë prej egoizmit të tij. Pse sipas teje egoizmi nuk shkon krah për krah me dashurinë?

Çfarë ndryshimi ka mes dashurisë dhe dashurimit? Përpiqu ta shpjegosh.

## Të rriturit: MËSUESIT

**MËSUESI I FIZIKËS:** është protagonist i një episodi të pakëndshëm. Çfarë bën?

**MËSUESI DI VITORIO** i përket kategorisë së “mësuesve të motivuar”: i nxit nxënësit, i përfshin, i kupton dhe i vë përpara kufizimeve të tyre. Çfarë dëshiron të arrijë ai me këtë?

Cilin prej të dyve e dëgjojnë më shumë nxënësit? Pse?

Cili është mësuesi i ëndrrave të tua? Ai që u vë të gjithëve nota të larta, ai që e përfundon gjithmonë programin apo ai që është i aftë t'i dëgjojë nxënësit e tij, të njohë dhe të vlerësojë talentet e tyre, të përçojë pasionin e tij? Rendit karakteristikat e tij në një fletë letre dhe krahasoju ato me shokët e klasës

## RREGULLAT DHE LIGJSHMËRIA

Në këto kapituj flitet shumë për rregullat. Rregullat e shtëpisë (rregullo dhomën tënde), rregullat e sjelljes në shkollë, rregullat e pashkruara të shoqërisë dhe pastaj ligjet e mirëfillta, të cilat janë rregullat e shkruara të një komuniteti.

**1.** Respektimi i normave të vendosura nga të tjerët mund të jetë bezdisës, ndoshta i mërzitshëm, por le të përpiqemi të mendojmë se çfarë do të ndodhte nëse rregullat nuk do të ekzistonin. Imagjino një rregull nga këto situata dhe shkruaj një histori të shkurtër (1 faqe):

- Futboll pa rregulla: një sport i ri?
- Rrugës si të më dojë qejfi
- Në shkollë pa detyrime
- Në kuzhinë pa receta

Një katastrofë e vërtetë, apo jo? Fakti është se, kur jeton me të tjerët, rregullat janë të nevojshme: nëse të gjithë do të ishin të lirë të bënin çfarë të donin, do të përfundonin duke kufizuar lirinë e të tjerëve. Rregullat u vendosin të gjithëve kufizime për të siguruar që të gjithë të kenë të drejtën për të qenë të lirë. Ato shërbejnë gjithashtu për të arritur një rezultat. Për secilën nga situatat e mësipërme (a, b, c, d), tregoni qëllimin për të cilin shërbejnë rregullat.

**2.** Mundohu të ripërshkosh atë që Danieli bën së bashku me Maksimin, nga Plej Steshioni e më tutje. Rendit veprimet e tyre dhe trego se ku fillon paligjshmëria. Çfarë i shtyn ata të kryejnë krime të vogla (veprime që shkonjë kundër ligjit)? Cili është më i rëndë apo ai që të ka prekur më shumë? Pse?

**3.** Kushtetuta është ligji më i rëndësishëm i një shteti: shpjegon parimet dhe rregullat që rregullojnë jetën e njeriut me njerëzit e tjerë, përshkruan të drejtat dhe detyrat e secilit. Gjithashtu përcakton se si funksionon një republikë dhe mekanizmat e saj. Në total, Kushtetuta përbëhet nga shumë nene. Krimet përshkruhen në Kodin Penal: bëj një kërkim të vogël dhe shkruaj përmbajtjen e tij.